

## **Abstrakt**

E drejta e votës është e drejtë themelore, që garantohet me Kushtetutën e Republikës së Kosovës.

Ajo garantohet me Deklaratën Universale për të Drejtat e Njeriut, me Paktin Ndërkombëtar për të Drejtat dhe Liritë Civile dhe Politike, si dhe garantohet me Konventën Evropiane për të Drejtat e Njeriut dhe e cila nënkupton të drejtën për të zgjedhur dhe për tu zgjedhur, në bazë të kushteve dhe kriterëve që përcaktohen me Kushtetutë, ligje dhe akte nënligjore që janë në fuqi.

Është e drejtë që në Republikën e Kosovës, garantohet edhe për shtetasit që gjenden jashtë Republikës së Kosovës, në ditën e zgjedhjeve.

Kjo do të thotë se shtetasit e Republikës së Kosovës, që gjenden jashtë vendit në ditën e zgjedhjeve të Republikës së Kosovës, mund të votojnë nga vendi ku gjenden.

Ligji për Zgjedhjet e Përgjithshme në Republikën e Kosovës, i mundëson shtetasve që gjenden jashtë Republikës së Kosovës, të votojnë përmes postës.

Në këtë temë do të trajtohen të gjitha çështjet, që ndërlidhen me ushtrimin e së drejtës së votës, për shtetasit që gjenden jashtë Republikës së Kosovës.

Fjalët kyçe: Vota, Kushtetuta, E drejta e votës, Shtetasit jashtë vendit.